



UDHËZUES

PËR PËR KRIJIMIN DHE OPERIMIN E SKEMAVE TE KOMPOSTIMIT NË KOMUNITET

Ky dokument është përgatitur nga Programi për Decentralizim dhe Zhvillim Lokal (dldp), me mbështetjen financiare të Agjensisë Zvicerane për Zhvillim dhe Bashkëpunim (SDC).

Ky publikim reflekton mendimet e autorëve dhe jo detyrimisht të SDC

Përgatiti:
METROPOLIS

Publikuar nga:
Programi për Decentralizim dhe Zhvillim Lokal (dldp)

HELVETAS Swiss Intercooperation | Albania
Adresa: Rruga "Ibrahim Rugova",
Pallati i PLUS, kati i 2-të / Nr. 3. Tiranë | Shqipëri
www.dldp.al | www.km.dldp.al

Falenderime.....	4
1. HYRJE.....	5
1.1 Çfarë është Udhëzuesi për kompostimin në Komunitet	5
1.2 Rëndësia e Kompostimit të Mbetjeve	6
1.3 Avanzatizet lokale nga kompostimi i mbetjeve	8
2. Teknologjia e Kompostimit	9
2.1 Llojet e kompostimit	9
2.1.1 Procesi Aerob.....	9
2.1.2 Procesi Anaerob	10
2.2 Faktorët që ndikojnë në procesin e kompostimit	11
2.2.1 Raporti mes Karbonit dhe Azotit	11
2.2.2 Sipërfaqja dhe Madhësia e Copëzave	12
2.2.3 Ajrimi.....	12
2.2.4 Lagështira.....	12
2.2.5 Temperatura	13
3. Kompostimit në Komunitet.....	13
3.1 Pse kompostimi ne komunitet? – sa mbetje gjenerohen nga qytetaret dhe shkurtimisht pse duhet ti kompostojme ato	13
3.2 Metodologjia e ndjekur – Kompostimi ditë pas dite	14
3.2.1 Detyra 1: Grumbullimi dhe përgatitja e mbetjeve të gatshme për kompostim	15
3.2.2 Detyra 2: Peshimi i mbetjeve të gjeneruara	15
3.2.3 Detyra 3: Transportimi i Mbetjeve në Kosh	16
3.2.4 Detyra 4: Matja e temperaturës së kompostit.....	16
3.2.5 Detyra 5: Shpërndarja dhe kthimi i përgut.....	16
3.2.6 Detyra 6: Ujitja e përgut të kompostimit	17
3.2.7 Detyra 7: Mbulimi i koshit me materiale të thata	17
3.3 Infrastruktura për realizimin e procesit të kompostimit	17
3.3.1 Madhësia e koshit.....	19
3.3.2 Vendodhja e përshtatshme për koshin e kompostimit.....	20
3.3.3 Materiale të tjera për kryerjen e procesit.....	20
3.4 Mbetjet organike të përshtatshme për kompostim	21
3.4.1 Mbetje jo të përshtatshme	21
3.5 Si të dallojmë kompostin final dhe çfarë mund të bëjmë me të?	22
4. Kompostimi në Shkollë.....	22
4.1 Fillimi i një procesit – koordinimi dhe miratimet me institucionet	22
4.2 Ngritja e një grupi pune dhe alokimi i përgjegjësi	23
4.3 Hartimi i një Plani Operacional	24
4.4 Hartimi i një programi sensibilizimi mbështetës	24
4.5 Rritja e njohurive teorike dhe praktike	25
4.6 Përmirësimi dhe konsolidimi i programit të kompostimit	26
4.7 Vazhdimi dhe mbështetja	27
5. Kompostimi në Komunitet”(Familje)	27
5.1 Ngritja e grupit të punës	28
5.2 Identifikimi i familjeve të cilat duan të jenë pjesë e programit të kompostimit – pyetësorët 28	
5.3 Prezantimi paraprak	29
5.4 Ndjekja dhe përmirësimi i procesit të kompostimit	30

5.5	Subvencionimi i skemës së kompostimit	30
6.	Programi i Vlerësimit dhe Monitorimit	31
7.	Aneksi 1: PYETËSOR PËR KOMPOSTIMIN NE KOMUNITET TE MBETJEVE	32

Falenderime

Udhëzuesi për krijimin dhe operimin e skemave të kompostimit në komunitet, që prej këtu e në vazhdim quhet “Udhëzues” është rezultat i përpjekjeve intensive dhe eksperiencave të deritanishme dhe vijon si një proces i ngushtë konsultimesh dhe bashkëpunimi me grupet e interesit në Bashkinë Pukë dhe Fushë-Arrëz.

Ky Udhëzues u përgatit nga stafi i Metropolis, me mbështetje të ekspertëve të fushës nga Bashkitë Pukë dhe Fushë-Arrëz, në kuadër të fazës së tretë të programit për decentralizimin dhe zhvillim lokal (dldp).

Falenderojmë të gjithë bashkëpunëtorët, që ofruan sugjerime dhe kontribute, ishin pjesë e trajnimeve dhe zbatimit të procesit të kompostimit në komunitet, rezultatet e së cilëve ndihmuan në hartimin dhe formatimin e këtij dokumenti në drejtimin e duhur.

1. HYRJE

1.1 Çfarë është Udhëzuesi për kompostimin në Komunitet

“Përmbledhja për Zbatimin e Procesit të Kompostimit në Komunitet”, është një udhëzues praktik për NJQV-te dhe qytetarët të cilët shfaqin interesin për kryerjen e procesit të kompostimit. Ky udhëzues hartohet në kuadër të fazës së tretë të Programit për Decentralizimin dhe Zhvillimin Vendor (dlp) në Qarkun e Shkodrës, përkatësisht në Bashkitë Pukë, Luf Qerret, Qelëz, Qafë Mali dhe Fushë – Arrëz.

Qëllimi kryesor i këtij udhëzuesi, është ofrimi i një udhëzuesi të plotë dhe efektiv për NJQV-të dhen komunitetet lokale të që të kenë mundësi të aplikojnë skema kompostimi në komunitet.

Udhëzuesi për Zbatimin e Procesit të Kompostimit në Komunitet reflekton eksperiencën e fituar gjatë zhvillimit të trajnimit të trajnerëve në Bashkinë Pukë dhe Fushë-Arrëz, dhe zhvillimit dhe zbatimit të projektit të kompostimit në këtë komunitet.

Në kuadrin teorik, ky udhëzues mbështetet në një përdorim të gjerë të literaturës ndërkombëtare, si udhëzues, udhëzues, material lidhur me praktikën dhe teknologjitë më të mira të kompostimit në komunitet.

Në këtë udhëzues lexuesi do të gjejë një dokument praktik dhe të strukturuar, për ta dihuar atë të kuptojë rëndësinë e kompostimit, kontekstin e gjerë në të cilin ndodh procesi, si dhe i mundëson atij një guidë hap pas hapi për realizimin e një procesi të sukseshëm kompostimi dhe përfundimin e një produkti të mirë në fund të tij. Për ta bërë më të lehtë këtë udhëzuesi është strukturuar në 7 kapituj si më poshtë:

1. Rëndësia e kompostimit të mbetjeve – prezanton lexuesin me një vështrim të përgjithshëm mbi problematikën lidhur me manaxhimin e mbetjeve në Shqipëri, dhe parashtron rëndësinë e kompostimit, si një nga alternativat më të qëndrueshme, mbështetur kjo dhe në sfidat dhe objektivat e Planit Kombëtar të Manaxhimit të Mbetjeve në Shqipëri
2. Avantazhet Lokale të kompostimit – reflekton kuadrin teorik lidhur me procesin e kompostimit, duke e bërë lexuesin më të ndërgjegjshëm mbi avantazhet e përdorimit të kësaj metode. Në këtë kapitull lexuesi do të ketë mundësi të krijojë një pamje të përgjithshme të procesit biologjik, dhe elementëve kyç të lidhur me kompostimit.
3. Kompostimi në komunitet – fokusohet në aspektet manaxheriale të procesit të kompostimit, duke i dhënë një pasqyrë të qartë mbi rëndësinë dhe metodologjinë e

zbatimit dhe ndjekjes së një procesi kompostimi në komunitet. Në këtë seksion, prezantohen hap pas hapi të gjitha aktivitetet që duhen ndërmarrë për arritjen e objektivave të kompostimit dhe përfundimit të një produkti të dobishëm

4. Kompostimi në shkolla – është një nga alternativat më të mira për prezantimin e koncepteve me qëllim rritjen e ndërgjegjësimit dhe të bërit të procesit më të zbatueshëm. Në këtë kuadër, ky kapitull prezanton metodologjinë e qasjes së prezantimit të një procesi të tillë në shkolla, duke parashtruar në këtë mënyrë hapat që duhet të ndiqen nga autoritetet vendore për ta bërë të realizueshëm këtë hap.
5. Kompostimi në familje – sikurse kompostimi në shkolla, zbatimi i një procesi në familje është një nga objektivat kryesore të Njësive Vendore. Ky kapitull prezanton hapat që duhet të ndiqen për zbatimin në masë të këtij hapi, duke identifikuar të gjithë aktorët dhe përgjegjësitë për ta bërë të mundur këtë.
6. Mësimet e nxjerra – reflekton arritjet e deri tanishme dhe eksperiencën e fituar gjatë zbatimit të procesit të kompostimit në Bashkinë Pukë dhe Fushë-Arrëz. Prezanton një pasqyrë të arritjeve të deri tanishme dhe sfidave të mëtejshme të projektit
7. Programi i Vlerësimit dhe Monitorimit – identifikon indikatorët që bëjnë të mundur matjen e performancës për zbatimin e procesit. Ky kapitull analizon mbledhjen e vazhdueshme të të dhënave dhe mundohet të krahasojë objektivisht rezultatet e arritura me ato të planifikuara.

1.2 Rëndësia e Kompostimit të Mbetjeve

Kompostimi në komunitet rrallë gjeneron përfitime nga vetja. Megjithatë, kur shihet si një component i një program për manaxhimin e integruar të mbetjeve të ngurta, kompostimi mund të ofrojë përfitime ekonomike në një shkallë të gjerë. Kur konsiderojmë sasinë e madhe të fraksionit organik që gjenerohet në vendet në zhvillim, qeveritë dhe komuniteti mund të kursejnë para; duke reduktuar sasinë e mbetjeve që duhet të grumbullohet, transportohet, depozitohet dhe tarifohet për qytetarët. (Hoomæg, et Thomas, Otten 1999).

Që nga viti 1994, grumbullimi dhe transporti i mbetjeve, si dhe shërbime të tjera të pastrimit i janë deleguar autoriteteve vendore, duke i bërë plotësisht përgjegjëse për manaxhimin e tyre. Sistemi i trashëguar dhe që vazhdon të operojë konsiston në grumbullimin e mbetjeve të ngurta urbane në një rrymë të vetme dhe transportimin e tyre në vendet lokale të depozitimit. Prosesi i delegimit të kompetencave, me gjithë përmirësimet graduale të vërejtura, është ende një sfidë e

fortë për autoritetet lokale, të cilat duhet të përballen me mungesën e instrumenteve të duhura për manaxhimin mjedisor të mbetjeve, mungesën e teknologjive dhe investimeve.¹

Plani kombëtar i manaxhimit të mbetjeve, i miratuar në vitin 2011 sipas VKM-së Nr.175, datë 19.01.2011 përcakton objektiva sfiduese, por realiste për manaxhimin e qëndrueshëm të mbetjeve në Shqipëri. Ky plan bashkon elementet strategjike të Politikës Kombëtare për Mbetjet 2010 dhe Strategjisë Kombëtare për Mbetjet dhe i vë ato në një kontekst koherent, të arritshëm dhe të qëndrueshëm duke siguruar zbatimin e një plani udhëzues të detajuar që vendi të përparojë nga ky standart i përcaktuar në një standart konceptimi për menaxhim teresor të mbetjeve, në përputhje me kërkesat e Kuadrit Udhëzues për Mbetjet dhe të Udhëzimeve të tjera për mbetjet deri në 2025².

Edhe pse nivelet e prodhimit të mbetjeve janë nën mesataren, sistemet e grumbullimit dhe heqjes së mbetjeve janë të prapambetura dhe për këtë arsye rezulton se dëmtimet mjedisore janë relativisht të larta. Nga ana tjetër, niveli aktual i riciklimit është gjithashtu shumë i ulët. Ndryshimi i kësaj situatë do të kërkojë kohë, dhe përpjekje të përbashkët të të gjithë aktorëve. Një sipërmarrje e tillë duhet të jetë e planifikuar mirë në nivel lokal, rajonal dhe kombëtar. Për këtë arsye, fokusi kryesor i objektivave të Planit Kombëtar të Manaxhimit të Mbetjeve është zbatimi i një sistemi planifikimi të thjeshtë por efektiv.³

Rëndësia e kompostimit është rritur ndjeshëm në ndërgjegjen publike në vitet e fundit, kjo pasi është një nga metodat më miqësore ndaj mjedisit, dhe një mënyrë e sigurtë për ti bërë kopshtet tona të lulëzojnë dhe prodhimet tona të rriten shëndetshëm. Arsyet e shumta përse kompostimi është aq thelbësor, janë kuptuar më thellësisht kohët e fundit për shkak të çështjeve të shumta të adresuara vazhdimisht rreth globit dhe mjedisit. Sic rekomandohet dhe në Planin Kombëtar të Manaxhimit të Mbetjeve, nënvizuar edhe nga direktivat e BE për përafrimin e legjislacionit Mjedisor në Shqipëri, NJQV-të inkurajohen të marrin në konsideratë zbatimin e procesit të kompostimit të komponentëve të caktuar të mbetjeve të biodegradueshme (organike) si një alternativë e rëndësishme për trajnimin e mbetjeve të tyre.

Faktet tregojnë se ende nuk është ndërtuar në Shqipëri ndonjë objekt apo impiant lokal ose privat për kompostimin e mbetjeve. Autoritetet vendore nuk kanë qënë të interesuara më parë për të kompostuar mbetjet, për sa kohë kanë patur një alternativë më të lirë për trajtimin e mbetjeve, duke i depozituar ato falas në vendgrumbullim/landfill, ose duke i hedhur në mënyrë ilegale në anët e rrugëve, shtratet e lumenjve, kanalet ujitëse etj. Në Shqipëri, kompostimi ka potencialin të përfaqësojë një metodë ekonomike dhe mjedisore për trajtimin e mbetjeve dhe reduktimit të

¹ Referuar udhëzuesit "Planifikimi i Manaxhimit Lokal të Mbetjeve", dldp

² Referuar "Planit Kombëtar për Manaxhimin e Mbetjeve në Shqipëri", Gusht 2010

³ Idem

sasisë së destinuar për vend depozitime, e cila llogaritet se mund të shmangë 50-60% të rrymës së mbetjeve urbane nga depozitimi.

Kufizimet e mëtejshme për depozitim të mbetjeve si dhe vendosja e tarifave të reja të grumbullimit të mbeturinave, do të nxisin jo vetëm interesin e NJQV por dhe të vetë qytetarëve për të kompostuar mbetjet organike, kryesisht për zonat rurale dhe ndërrurbane.


Iniciativa informale të kompostimit janë identifikuar në vend, kryesisht nga një numër banorësh që jetojnë në komuna, të cilët historikisht i kanë përdorur mbetjet e tyre organike për ushqim për kafshët, plehërim ose për qëllime të tjera. Në të njëjtën kohë, kërkesa për plehra organike ka ardhur në rritje, duke u përdorur gjerësisht në sektorët e bujqësisë dhe pemtarisë. Kur kjo pjesë organike e rrymës së mbetjeve urbane të mbledhet veçmas, atëherë pjesa më e madhe e këtij materiali mund të kompostohet dhe të kthehet në një produkt të përshtatshëm për përdorim të plehës organik dhe përmirësimit të pjellorisë së tokës.

1.3 Avantazhet lokale nga kompostimi i mbetjeve

Ndërkohë që dekompozimi është një proces natyral i cili ka filluar që me krijimin e tokës, kompostimi nuk është gjë tjetër vecse një përshpejtim i proceseve natyrore nga njeriu, ose siç do të shpreheshin kopshtarët është kthimi i mbeturinave organike, me ndihmë të mikroorganizmave, në “arin e zi”.

Kompostimi është një mënyrë e thjeshtë dhe e lirë për të krijuar lëndë ushqyese dhe pleh për kopshtet, kjo pasi është mënyra më e shpejtë për të hequr qafe mbeturinat që gjenerohen çdo ditë në kuzhinë, gjethet dhe mbetjet e tjera organike të grumbulluara në kopshte të cilat çdo ditë duhet ti fshijmë dhe hedhim jashtë oborreve tona. Ndërkohë që riciklimi i materialeve si plastika, qelqi apo letra kthehen në një iniciativë disi më të vështirë e cila kërkon angazhimin e një sërë

aktorësh, dhe një proces zinxhir, kompostimi është një mënyrë më e shpejtë për të ricikluar mbetjet organike në një produkt të dobishëm.



Megjithatë, avantazhet e kompostimit shkojnë edhe përtej vetëm oborrit të shtëpisë. Përqafimi i metodës së kompostimit ul ndjeshën numrin e qeseve të mbeturinave të destinuara për landfill duke

zvogëluar sasinë e mbetjeve të grumbulluara dhe duke rritur jetëgjatësinë e landfillëve. Kjo metodë do të mundësojë reduktimin e rrymës së mbetjeve direct në burim dhe pa kosto shtesë, në të njëjtën kohë që redukton kostot e grumbullimit të mbetjeve në kazanë apo transportimin e tyre. Krahas përfitimeve të shumta mjedisore, kompostimit mund të krijojë edhe përfitime financiare, duke prodhuar një produkt të shitshëm dhe të dobishëm për tregun.

Nga pikëpamja sociale, prezantimi i kompostimit si zgjidhje në komunitet, dhe sidomos në shkollë, është hapi I parë për rritjen e ndërgjegjësimit dhe një hap I rëndësishëm për uljen e gjurmës tonë mjedisore në planet. Duke iu referuar hierarkisë për manaxhimin e mbetjeve të ngurta, do të mund të kuptojmë që krahas ripërdorimit dhe riciklimit, zbatimi i metodës së riciklimit është një nga praktikatat më të parapëlqyera për minimizimin e mbetjeve dhe uljen e rrymës për depozitim në landfill. Fillimi I ndarjes së mbetjeve organike nga ato jo-organike, mund të jetë një hap I parë bazik, për rritjen e ndërgjegjësimit, dhe të mësuarit të qytetarëve me një kulturë të re dhe miqësore ndaj mjedisit.

2. Teknologjia e Kompostimit

2.1 Llojet e kompostimit

Kategorizimi i proceseve të kompostimit lidhet me llojin e mikroorganizmave të cilat sic u shpjeguan dhe më sipër kryejnë procesin e kompostimit. Dy janë kategoritë e mikroorganizmave të cilat konsumojnë dhe zbërthejnë materialet organike: ato që kanë nevojë për ajër (aerobe) dhe ato që nuk kanë nevojë për të (anaerobe).

2.1.1 Procesi Aerob

Kompostimi Aerob është parimisht I lidhur me procesin që kryhet në mjedis mbitokësor, të cilat mund të jenë grumbullime në kosha apo kazën me anë të hapura të cilat ofrojnë qarkullimin e ajrit brenda kompostit të grumbulluar. Nën praninë e ajrosjes, mikroorganizmat aerobike punojnë në mënyrë të shpejtë dhe më efikase se homologët e tyre anaerob, duke siguruar një produkt final në një afat kohor më të shkurtër. Megjithatë ndërkohë që organizmat vazhdojnë të kryejnë procesin e shpërbërjes së materialeve organike, sasia e oksigjenit në koshin e kompostimit mund të reduktohet, duke bërë që procesi të ngadalësohet dhe temperatura brenda kompostit të ulet. Dekompozuesit mbitokësorë aerobë mund të përballojnë temperature më të larta se homologët e tyre anaerob, duke gjeneruar kështu nxehtësi si efekt anësor I veprimtarisë së tyre. Jo të gjitha shtresat e kompostit të grumbulluar janë të nxehta, por nëse kushtet janë të


favorshme për dekompozuesit, temperaturat në grumbullin e mbetjeve aarin deri në nivele të mjaftueshme për të vrarë farat e këqija dhe patogjenët.

2.1.2 Procesi Anaerob

Ndryshe nga organizmat aerobe, organizmat anaerobe punojnë pa oksigjen, pra siç mund të kuptohet procesi I kompostimit ndodh në nëntokë. Në thelb ajo që nevojitet është hapja e një grope në fund të kopshteve tuaja, mbushja me lëndën organike, dhe mbyllja e saj me një shtresë toke. Që nga ky moment organizmat anaerobe janë të gatshme të fillojnë shpërbërjen e mbetjeve organike pa patur nevojë për praninë e oksigjenit.

Megjithëse në pamje kompostimi anaerob duket më I thjeshtë, dhe kërkon më pak angazhim, procesi në të cilin ndodh kompostimi është më I ngadaltë. Avantazhet e tjera lidhur me këtë metodë kompostimi lidhen me pamundësinë për të monitoruar progresin, gjenerimit të aromave të pakëndshme në mungesë të ajrosjes si dhe pamundësisë për të shkatërruar farën e keqe apo patogjenët, për sa kohë komposti ndodh në kushte të ftohta dhe nuk prodhon nxehtësi.

Procesi anaerob, nga ana tjetër, në mënyrë që të maksimizojë efektivitetin e tij, duhet të jetë pjesë e një infrastrukture gjithëpërfshirëse dhe të kushtueshme, e cila angazhon të gjithë komunitetin dhe ndikon në infrastrukturën e përgjithshme të tij. Në përgjithësi, aplikimi i procesit anaerob, bëhet për të përfutur jo vetëm plehun final nga dekompozimi i mbetjeve, por mbi të gjitha për të prodhuar biogas, shumëi përdorshëm për ngrohjen qendrore të komunitetit.



2.2 Faktorët që ndikojnë në procesin e kompostimit

Nën kushtet natyrore, të gjitha materialet organike janë të dekompozueshme. Megjithatë ky proces mund të zgjasë me muaj ose edhe me vite, varësisht në kushtet klimaterike nën të cilat ndodh dekompozimi. Por, procesi natyror i dekompozimit mund të përshpejtohet nga njeriu duke kontrolluar disa nga faktorët më të rëndësishëm që marrin pjesë në procesin e dekompozimit. Disa nga faktorët më të rëndësishëm janë si më poshtë:

2.2.1 Raporti mes Karbonit dhe Azotit

Karboni dhe azoti, janë dy komponentët më të rëndësishëm të cilët me shumë gjasa mund të ndikojnë në procesin dhe cilësinë e kompostit final, në rastet kur sasi e tyre është e mangët ose në tepriçë, ose në rastet kur raporti mes tyre nuk është në proporcionet e duhura. Gjatë procesit të kompostimit, mikro organizmat thithin nitrogenin për sintetizimin e proteinave, dhe tresin karbonin për të çliruar energji. Proporcioni mes këtyre dy elementëve duhet të jetë afërsisht 30:1,

megjithatë një raport i cili varion nga 25:1 deri në 40:1 konsiderohet si ideal për kryerjen e procesit të kompostimit.

Me mbajtjen e një raporti të qëndrueshëm, 30:1, mikroorganizmat mund të kryejnë procesin e dekompozimit më shpejtë duke rezultuar gjithashtu në një kompost final më cilësor. Ruajtja e këtij raporti mes karbonit dhe azotit në një kosh kompostitmi është rregullli bazë për një kompostim të mirë dhe cilësor. Në rastet kur raporti është në nivele mjet të ulëta, sasia e azotit është shumë e madhe, gjë që con në çlirimin e azotit në atmosferë dhe shkaktimin e aromave të pakëndshme. Në rastet kur raporti është më i madh, sasia e pakët e azotit, shkakton ngadalësimin të procesit të dekompozimit.

2.2.2 Sipërfaqja dhe Madhësia e Copëzave

Një nga mënyrat për përshtetimin e procesit të kompostimit është prerja e mbetjeve në grimca sa më të vogla, duke thjeshtuar më tej punën që do të kryhet më tej nga mikroorganizmat. Rritja e sipërfaqes së dekompozueshme u lejon mikroorganizmave të tresin më shpejt mbetjet, të riprodhohen më shpejt brenda llojit dhe të rrisin temperaturën në koshin e kompostimit. Përgjithësisht, sa më të vogla të jenë grimcat, aq më I lartë aktiviteti biologjik, dhe aq më e lartë norma e kompostimit.

Për këtë arsye do të sugjerohej, që mbetjet, sidomos ato të gjeneruara nga oborret tona, të prihen në copëza sa më të vogla.

2.2.3 Ajrimi

Procesi I ajrimit të një koshi kompostitmi nënkupton zëvendësimin e ajrit me mungesë të kufizuar në qendër të koshit, me ajër të pasur me oksigjen. Kompostitmi i shpejtë aerobic ndodh vetëm në praninë e sasive të mjaftueshme të oksigjenit. Miksimi i rregullt i koshit të kompostitmit, ose siç do ti referohemi më vonë, kthimi i kompostit, është mënyra më e mirë për të përshtetuar dhe nxitur ajrimin brenda një koshi kompostimi. Duhet mbajtur parasysh se gjatë javëve të para të fillimit të procesit të kompostitmi, sasia e e kërkuar e oksigjenit brenda koshit të kompostitmit është më e madhe sesa në një fazë të dytë.

2.2.4 Lagështira

Lagështia, sikundër dhe elementët e tjerë luan një rol të rëndësishëm në metabolizmin e mikroorganizmave dhe në mënyrë indirekte dhe në mundësimin e sasive të oksigjenit. Mikroorganizmat, arrinë të dekompozojnë vetëm ato grimca të mbetjeve ushqimore të cilat janë të tretura në ujë. Një nivel lagështie nga 40 – 60 % krijon një ambient të favorshëm për kryerjen e procesit. Në rastet kur niveli i lagështirës tenton të shkojë më poshtë se 40%, procesi i

kompostitmi do të ngadalësohet, duke shkaktuar një kohëzgjatje të përfundimit të produktit final. Ndërkohe që, nga ana tjetër, një nivel më i lartë se 60% i lagështirës në koshin e kompostimit, kthehet në një faktor të kësaj në prodhimin e aromave të pakëndshme

2.2.5 Temperatura

Nxehtësia e gjeneruar nga mikroorganizmat gjatë procesit të dekompozimit, rrit temperaturën në grumbullin e kompostimit. Në fakt ekziston një lidhje e drejtëpërdrejtë mes temperaturës, dhe nivelit të konsumimit të oksigjenit. Sa më e lartë temperatura aq më i lartë është aspirimi i oksigjenit, që do të thotë aq më shpesh do të ndodhë procesi i kompostimit. Megjithatë, edhe pse rritja e temperaturës brenda koshit të kompostimit është një dukuri e cila vihet re që në orët e para të krijimit të grumbullit të kompostitmi, niveli I saj duhet të mbahet nën kontroll. Kufinj të optimale të ruajtjes së temperaturës variojnë nga 32°C – 60°C. Në javët e para të fillimit të procesit, vihet re një rritje e menjëhershme e temperaturave brenda koshit të kompostitmi, të cilat qëndrojnë në nivele konstante në mes të procesit deri sa fillojnë të bien gradualisht në temperaturën e ambientit, në kohën kur produkti final është krijuar.

3. Kompostimi në Komunitet

3.1 Pse kompostimi në komunitet? – sa mbetje gjenerohen nga qytetaret dhe shkurtimisht pse duhet ti kompostojmë ato

Kompostimi lokal ose në komunitet përfaqëson një alternativë vendore apo komunitare për dekompozimin e mbetjeve organike. Kompostimi është metoda më e lirë dhe më e thjeshtë e cila mund të jetë një alternativë e përshtatshme për kontekstin vendor shqiptar.

Sipas Planit Kombëtar të Mbetjeve rreth 47% e mbetjeve ditore të prodhuara nga banorët⁴, çdo ditë, janë mbetje organike, shumë të përshtatshme për kompostim. Ripërdorimi i këtyre mbetjeve mund të përdoret gjerësisht për të prodhuar pleh organik që mund të përdoret gjerësisht në bujqësi, në lulishtet e qytetit, apo për nevoja të tjera. Siç shpjegohet edhe në kapitujt paraardhës, kompostimi mund të përdoret për të përpunuar mbetjet e kopshtit të shtëpive, ushqimet letrën dhe mbeturinat nga kanalizimet.

Megjithatë, të mirat e kompostimit shkojnë përtej përmirësimit të kopshteve individuale. Kompostitmi i mbeturinave të gjeneruar në kuzhinë apo në oborre, në vënd që të grumbullohen

⁴ Si mesatare kombëtare e përbërjes organike, sipas planit kombëtar të mbetjeve

dhe të hidhen në koshat e mbeturinave, ofron një rrugë alternative dhe miqësore ndaj mjedisit për tu bërë pjesë e zgjidhjes së përbashkët për çështje të tilla si: mbingarkesa në venddepozitimet e mbetjeve, dotja dhe ngrohja globale. Disa arsye pse kompostimi është një zgjidhje efektive për devijimin e mbetjeve të kompostueshme organike nga vend depozitimeve të mbetjeve:

- Kompostimi zgjat jetëgjatësinë e vend depozitimeve të mbetjeve dhe landfillleve, dhe redukton mundësinë për krijimin e zonave të tjera
- Kompostimi redukton kostot e transportit dhe ndotësit e ajrit të shkaktuar nga qeset e mbeturinave në pikat e grumbullimit
- Ndërkohë që mbetjet organike dekompozohen në vendgrumbullim apo landfill, ato gjenerojnë lëngje të cilat dëmtojnë nëntokën dhe kontaminojnë ujërat nëntokësor.
- Dekompozimi I mbetjeve organike në landfill, në mungesë të pranisë së oksigjenit, prodhon metan, I cili është në gaz serë.
- Djegia e mbeturinave nuk është një opsion I përshtatshëm për zonat urbane, kjo shkakton ndotje në mjedis, dhe ndikon në shëndëtin publik
- Kompostimi në komunitet trajton mbetjet direct në burim, pa kosto të mëdha, si dhe redukton kostot e grumbullimit dhe transportimit të mbetjeve në vend depozitime
- Një proces i tillë mund të sigurojë compost/pleh organic për përmirësimin e tokave bujqësore, kopshteve serave apo edhe lulishteve të qytetit
- Prezantimi i praktikave të kompostimit i jep mundësinë NJQV-ve për të testuar dhe vlerësuar procesin, me qëllim mundësinë e maksimizimit të procesit të kompostimit
- Zbatimi në masë dhe me sukses i një procesi kompostimi, krijon premise drejt ndërtimit të një impianti më të madh

Në dukje prezantimi i kompostimit, është një zgjidhje e leverdisshme për të gjithë, megjithatë disavantazhet e këtij procesi lidhen kryesisht me mungesën e njohurive të përgjithshme mbi procesin e kompostimit. Duke qënë një proces relativisht aktiv, zbatimi me sukses I kompostimit kërkon impenjim nga një grup I gjerë aktorësh, të cilët duhet të kenë njohuritë e duhura për arritjen e objektivave. Nga ana tjetër, prezantimi I praktikave të tilla në Shqipëri është një sipërmarrje e re, e pa aplikuar në masë, duke I vënë Njësitë vendore përpara sfidave të mëdha si pasojë e mos paturit të eksperiencave të mëparshme.

3.2 Metodologjia e ndjekur – Kompostimi ditë pas dite

Kapitulli i mëposhtëm, evidenton hapat bazë për kryerjen e një procesi të mirë kompostimi ditë pas dite. Me qëllim realizimin e një produkti final të suksesshëm, vëmëndje e vecantë duhet ti kushtohet të gjithë hapave të përshkruara në metodologjinë si më poshtë. Çdo pakujdesi, gjatë procesit, ndikon ndjeshëm në cilësinë e kompostin dhe kohëzgjatjen e procesit.

3.2.1 Detyra 1: Grumbullimi dhe përgatitja e mbetjeve të gatshme për kompostim



Mbetjet organike të gjeneruara në familje, mund të grumbullohen fillimisht në kosha të vecantë, të cilat mund të mbahen në kuzhinë apo në kafeterinë e shkollës. Duhet patur kujdes që, që në fillimin të grumbullimit të mbetjeve për kompostim, të bëhet një seleksionim I kujdesshëm I atyre lloj mbetjeve të cilat rekomandohen të bëjnë pjesë në kosh.

Sasia më e madhe e mbetjeve të përshtatshme për kompostim, gjenerohet nga mbeturina të grumbulluara nga kopshtet. Këto të fundit, siç do ti referohemi më tej në udhëzues, konsiderohen si mbetje të kafenjta, shumë të pasura me karbon. Mbetjet që mund të mblidhen nga kopshtet mund të përfshijnë: degët e thyera të pemëve, sasi të e korrura të barit, bime të kalbura, ashklat apo gjethet e rëna të pemëve etj. Përpara se këto të dërgohen në koshin e kompostimit, mund të grumbullohen në kuti të mëdha (mbetjet e letrës gjithashtu mund të jenë pjesë e kompostimit), ose në një cep të përshtatshëm të oborrit. Një hap i rëndësishëm për këtë proces përgatitor mund të jetë copëtimi I mbetjeve (kryesisht atyre bimore) në mënyrë që të jenë të përshtatshme për koshin e kompostimit, sikurse dhe të ndihmojë në përsheptimin e dekompozimit të tyre.

3.2.2 Detyra 2: Peshimi i mbetjeve të gjeneruara



Në kapitullin e mësipërm, janë nënvizuar faktorët që ndikojnë një process kompostimi, ku rëndësi e vecantë i kushtohet raportit të karbonit dhe azotit në përgun e mbetjeve. Në mënyrë që të mund të kontrollohet ky raport, sugjerohet peshimi I materialeve të gjeneruara përpara se ato të transportohen në kosh. Sic përmendet dhe më sipër, sasia e mbetjeve të kafenjta të gjeneruara duhet të jetë më e madhe se ajo e mbetjeve të gjelbërta gjeneruar në kuzhinat e shtëpive.

Ruajtja e raportit 30:1 ndihmon procesin e kompostit, dhe garanton cilësinë e produktit final të prodhuar. Për këtë arsye është e nevojshme që në shumë raste mbetjet të mos depozitohen menjëherë në koshin e kompostimit, pa garantuar më parë ruajtjen e këtij raporti.

Nga ana tjetër, mbajtja shënim e peshës totale të mbetjeve përpara kompostit, mund të shërbejë si indikatorë për shumë çështje të tilla si: sasia e mbetjeve organike të future në process, raporti

mes sasisë së mbetjeve të dekompozueshme dhe kopostit final, sasia e mbetjeve të kompostuara për njësi kohe etj.

3.2.3 Detyra 3: Transportimi i Mbetjeve në Kosh

Pas grumbullimit, dhe sigurimit se është ruajtur një raport I mirë mes mbetjeve. Mbetjet e gjeneruara duhet të transportohen në koshin/koshat e kompostimit me ndihmën e një karroce apo barrele. Hedhja e materialeve në koshin e kompostit mund të jetë një process I përditshëm, megjithatë në rastet kur sasia e gjeneruar brenda një dite, nuk arrin normat e specifikuara më sipër, mbetjet mund të ruhen në koshat përkatës për një periudhë kohe jo më shumë se 3 ditë.

3.2.4 Detyra 4: Matja e temperaturës së kompostit



Fill pas hedhjes së një sasive të konsiderueshme në koshin, procesi I dekompozimit mund të konsiderohet i nisur. Mikro-organizmat fillojnë të punojnë dhe të shumohen me shpejtësi, duke bërë që temperature në pìrgun e kompostit të rritet ndjeshëm që në fillim të procesit. Me ndihmën e një termometri të posacëm për kompostim, është e rëndëishme matja e herëpashershme e temperaturës në pìrg. Sipas rregullave të listuara në kapitullin paraardhës, ndryshimet e ndjeshme në temperaturë mund të cënojnë cilësinë e produktit. Për këtë arsye kthimi dhe ujitja e pìrgut sic shpjegohen më poshtë ndihmojnë në balancimin e temperaturës.

3.2.5 Detyra 5: Shpërndarja dhe kthimi i pìrgut



Në rastet ideale mbetjet e kafenjta, si për shembull copat e drurit, gjethet, etj, për shkak të formës dhe cilësisë së tyre, garantojnë hapjen e xhëpave të ajrimit Brenda një pìrgu kompostimit. Megjithatë, gjatë miksimit të këtyre të fundit me mbetjet nga kuzhina, pìrgu i kompostimit mund të fitojë një lloj kompaktësimi me kalimin e kohës. Ulja e temperaturës, është indikator i mirë i kësaj dukurie. Kthimi I herëpashershëm I pìrgut ndihmon në ajërosje dhe në shtimin e oksigjenit brenda koshit të kompostimit. Kthimi, thjeshtësisht nënkupton rimiksimin e materialeve brenda në kosh. Ky process mund të kryhet me ndihmën e

një piruni, apo lopate duke sjellë mbetjet nga anët e ftohta të koshit drejt qendres së pirlgut. Brenda disa ditëve, temperatura në kosh duhet të fillojë të stabilizohet dhe të arrijë rreth 32°C.

3.2.6 Detyra 6: Ujitja e pirlgut të kompostimit

Mikroorganizmat, arrinë të dekompozojnë vetëm ato mbetje të cilat janë të tretura në ujë. Gjatë periudhës së dimrit, ujitja e koshit të kompostimit mund të vijë nga procese natyrore si shiu por, kujdesi me ujitjen e herepashershme duhet të konsiderohet gjatë stinëve të nxehta, ku niveli I lagështisë në pirlg mund të zbrësë nën normat e specifikuara në kapitullin paraardhës.



3.2.7 Detyra 7: Mbulimi i koshit me materiale të thata

Pas përfundimit të proceve ditorë të shpeguara më sipër, këshillohet që koshi I kompostimit të mbulohet nga një shtresë e konsiderueshme materialesh të thata, si tallash, gjethet apo ashklat e pemëve, drunj të thatë etj. Këto material mbulojnë, mbetjet ushqimore, duke I bërë këto të fundit më pak atraktive për kafshët dhe insektet, dhe duke ruajtur temperaturat konstante brenda koshit të kompostimit.

3.3 Infrastruktura per realizimin e procesit te kompostimit

Procesi I kompostimit është një iniciativë relativisht e thjeshtë, megjithatë për realizim me sukses kërkohet angazhim I plotë ditë pas ditë, për arritjen e rezultateve të dëshirueshme. Ky seksion shpjegon shkurtimisht, se cila është infrastruktura bazë për realizimin e një procesi kompostimi, duke nisur me ndërtimitn e koshit të kompostimit, materialet që nevojiten për kthimin ditë pas dite, vendodhjen epërshtatshme etj.

Infrastruktura bazë që kërkohet për të kryer një process kompostimi është krijimi I koshit/koshave të kompostimit. Ekzistojnë disa mënyra për përfitimn e një koshi kompostimit. Mënyra më e thjeshte, por sigurisht dhe më e kushtueshme është blerja e koshave të gatshëm të kompostimit, të cilat janë të mundura në madhësi dhe cilësi të ndryshme. Megjithatë ky udhëzues rekomandon se metoda më e mirë është ndërtimi I koshit të kompostimit nga vetë angazhuesi, kryesisht me material të riciklueshme dhe aspak të kushtueshme. Ndërtimi I koshit të kompostimit nga paletat e gatshme, është një nga praktikrat më të thjeshta. Ato mund të jenë të

disponueshme nga kompanitë e transportit, mund të përftohen falas nga bizneset locale të cilat nuk I përdorin, ose mund të blihen me një çmim tepër të ulët.

Ekzistojnë disa rregulla bazë për ndërtimin e koshit, përfshirë dhe dy tipe kryesore:

- Ndërtimi I një koshi të vetëm kompostimi, I cili rekomandohet të ndërtohet në rastet kur sasisitë e gjeneruara të mbetjeve janë të vogla dhe angazhimi individual në process është më pasiv. Në këtë rast mbetjet e gjeneruara ditë pas dite, grumbullohen dhe lihen në një kosh deri në përfundimin final të kompostit, duke bërë të mundur vetëm kthimin e herëpashershëm të pirtgut, me qëllim ajrosjeje.

Bazuar në metodologji, dy janë mënyrat për realizimin e kompostit në shtëpi⁵ :

Është një nga mënyrat më të lehta për të dekompozuar mbetjet organike, sepse nuk kërkohet punë krahu përveç vendosjes së mbetjeve në një kosh, marrjes së plehut nga fundi I pirtgut pas një periudhe 8-12 muaj.	Pirtgu përzihet herë pas here gjë që siguron oksigjen për organizmat duke I mundësuar atyre të shpërbëjnë më shpejt plehun. Ajrosja e përjavshme sjell si rezultat pleh të gatshëm për më pak se dy muaj
Kompostimi Pasiv	Kompostimi Aktiv

Në përgjithësi, investimi fillstar për ngritjen e një kontenieri për kompostim në shtëpi (për një familje kushton rreth 40-60 Euro⁶.

- Në rastet kur mbetjet e gjeneruara janë në sasi më të mëdha dhe procesi kërkohet të ndodhë më shpejt, rekomandohet ndërtimi i 3-4 koshave të njëpasnjëshëm (në rresht). Arsyeja e përdorimit të kësaj metode, është se gjatë një procesi më aktiv të kompostimit, materialet e hedhura rishtazi mund të ngadalësojnë procesin e dekompozimit, kështu kthimi i pirtgut të kompostit në faza, dhe zhvendosja e tij në koshin tjetër përshpejton prodhimin e produktit final. Kompostimi në rreshta është I thjeshtë dhe ka një kosto të ulët krahasuar me metodat e tjera të ngjashme të trajtimit, si dhe mund të përdoret nga bujqit, NJQV-të sikurse dhe kompanitë e përpunimit të mbetjeve. Në përgjithësi kostoja e kësaj metode mund të ndryshojë midis 10-20 Euro⁷ për ton mbetje, kosto e cila përfshin shpenzimet kapitale, operative dhe të mirëmbajtjes.⁸

⁵ Refruar udhëzuesit “Planifikimi I Manaxhimit Lokal të Mbetjeve”, dldp

⁶ IBDR/WORLD BANK (2000), Strategic Planning Guide for Municipal Solid Waste Management

⁷ IBRD/WORLD BANK (1999), Composting and It’s Applicability in Developing Countries

⁸ Refruar udhëzuesit “Planifikimi I Manaxhimit Lokal të Mbetjeve”, dldp

Kompostimi në rreshta në rang komuniteti apo vendor mund të jetë një alternativë e favorshme për të trajtuar mbetjet urbane në zona të largëta dhe të vecuara sin ë rastin e Pukës dhe Fushë – Arrëzit.

Planifikimi dhe ngritja e një impianti për kompostim me rreshta duhet të marrë në konsideratë elementët e mëposhtë⁹ :

Vendi	Duhet të jetë pranë zonave të banimit për të ulur kostot e transportit
Kushtet specifike	Normalisht mund të vendoset në mjedis të hapur, por shpesh mund të mbulohet për shkak të kushteve klimatike, apo për të parandaluar erën e keqe, lagështirën dhe për të kontrolluar temperaturën e tij
Koha e nevojshme	Plehu është gati për një periudhë 6 deri në 8 muajsh
Koeficienti i pranimit	Normalisht, materialet hyrëse konsistojnë në rreth 90% të rrymës së mbetjeve organike
Produktiviteti	Pas dekompozimit plehu I përgatitur përbën vetëm 40% të masës së mëparshme për shkak të avullimit të ujit. Nga kjo, rreth 5-10% shkon për depozitim në landfill (p.sh gurë apo material që nuk janë ndarë në rregull)

3.3.1 Madhësia e koshit

Madhësia e rekomandueshme e koshit është 1m³ ose në dimensionet 1m x 1m x 1m. Kjo është madhësia që një familje tipikë mund të përdorë për kryerjen e një procesi pasiv të kompostimit. Me gjithatë, dukerr uajtur po të njëjtat dimensionet, ndërtimi I një serie koshash me njëërën nga anët e hapura, lejon kthimin e përgut me lehtësi nga njëri kosh në tjetrin. Përgjithësisht, materialet e hedhura rishtazi grumbullohen në koshin e parë. Pas mbushjes së këtij koshi, përgut kthehet në koshin e dytë, kjo pasi procesi i dekompozimit ka filluar dhe nuk mund të përzihet me materialet e freskëta të hedhura në të. Në një fazë të dytë, përgut kthehet nga koshi i dytë në të tretin, në të njëjtën kohë që koshi i parë grumbullon, vetëm materialet e hedhura rishtazi.

Megjithatë përcaktimi i madhësisë së koshit, varet qartësisht nga sasia e gjenerimit ditor të mbetjeve. Për përcaktimin më të saktë të madhësisë së koshit, rekomandohet peshimi I mbetjeve që një familje/komunitet gjeneron cdo ditë.

⁹ Idem



Pamje nga koshi i Kompostimit I ndertuar në Pukë

3.3.2 Vendodhja e përshtatshme për koshin e kompostimit

Përcaktimi i vendodhjes së koshit të kompostimit, është një vendim i cili duhet marrë me kujdes dhe në mënyrë strategjike. Sapo koshi të jetë ndërtuar dhe procesi i punës të ketë filluar vendodhja e tij nuk mund të ndryshojë. Koshi i kompostimit duhet të ndërtohet në një zonë të përshtatshme, në nivelin e tokës, për të mundësuar drenazhimin, dhe në një distancë relativisht larg nga shtëpia. Për këtë arsye rekomandohet që koshi i kompostimit të pozicionohet në pjesën e prapme të shtëpise, për arsye estetike dhe sigurie, kjo pasi askush nuk do dëshironte një kosh mbetjesh përpara verandës së shtëpisë. Nëse është e mundur, duhet evituar vendosja e koshit pranë një pikë grumbullimi mbetjesh, pika të tilla, shpesh janë tërheqëse për kafshët, dhe arkomat e pakëndshme apo gazrat që clirojnë këto pika mund të përzihen dhe të ndikojnë në procesin e kompostimit.

3.3.3 Materiale të tjera për kryerjen e procesit

Sapo koshi i kompostimit të jetë stabilizuar, dhe pozicionuar në një vend të favorshëm, procesi i kompostimit mund të nisë menjëherë. Më poshtë është renditur një listë e shkurtër mjetesh të cilat ndihmojnë dhe lehtësojnë punën me kompostin:

- Doreza llastiku
- Piruni/Lopata e kthimit të përgut
- Karroca për transportimin e mbetjeve
- Termometri i kompostit
- Zorrë uji

3.4 Mbetjet organike të përshtatshme për kompostim

Në gjuhën e kompostimit, mbetjet organike të përshtatshme për kompostim do të kategorizohen në dy lloje baze:

- Mbetjet ushqimore të gjeneruara nga kuzhina, ndryshe referuar si “të gjelbërta” të cilat janë të pasura me azot. Në këtë kategori mund të përfshihen, lëvoret e frutave dhe perimeve, bukë, lëvozhgët e vezëve etj
- Mbetjet e gjeneruara nga kopshti, si drunjtë, degët e thara etj, referuar si “të kafenjta” shumë të pasura me karbon.

Me shume Azot		Me shume karbon	
	C:N		C:N
jonxhe	12:1	hiri, drusore	25:1
terfil	23:1	Karton,	350:1
Mbetje kafeje	20:1	Mbetjet e frutave	35:1
Mbetje ushqimesh	20:1	gjethet	60:1
Mbetje kopshti gjelbra	30:1	Gazetat e copetuara	175:1
Bar l prere	20:1	Hala pishe	80:1
Mbetjet e kafsheve	15:1	tallash	325:1
Mbetje nga perimet	25:1	kashte	75:1
Farat	30:1		

3.4.1 Mbetje jo të përshtatshme

Gjatë përzgjedhjes së materialeve për koshin e kompostimit, duhet patur kujdes që asnjë mbetje e kategorive si më poshtë të mos bëhet pjese:

- Mbetjet shtazore si : mishi, kocka, mbetjet e peshkut etj
- Bulmeti : djathi, gjalpi, qumështi etj



- Mbetje të kafshëve
- Vajëra
- Mbetje organike të njoma etj

Përzjerja e materialeve të mësipërme me mbetjet e përshtatshme për kompostim, mund të shkaktojë deficienca në procesin e kompostimit, të cilat lidhen kryesisht me shfaqjen e aromave të pakëndshme,

ngadalësim të procesit, tërheqjen e kafshëve etj, dhe rezultojnë në një produkt final jo-cilësor, të papërfunduar dhe të pasur me lëndë kontaminuese.

3.5 Si të dallojmë kompostin final dhe çfarë mund të bëjmë me të?

Një proces i sukseshëm kompostimi duhet të rezultojë në një produkt të kafenjtë, të shkrifët dhe me aromë të këndshme, brenda një periudhe rreth një vjecare. Sigurisht që sasia e kripërave dhe lëndës ushqyese që përmban komposti final, varen dhe nga materialet organike të hedhura në koshin e kompostimit gjatë procesit. Megjithatë është e këshillueshme kryerja e disa analizave të thjeshta të kompostit, përpara se ai të vihet në përdorim. Vetëm sepse, produkti final i prodhuar, mund të ketë marrë pamjen e dheut, ai jo domosdoshmërisht është në kushtet më optimal për përdorim të menjëhershëm. Materialet pjesërisht të dekompozuar, mund të djegin, rrënjët e bimëve për shkak të sasive të paqëndrueshme të azotit. Kompostimi final, duhet të ketë një nivel neutral pH dhe nivel të ulët të azotit.

Ajo çfarë duhet të bëhet, është thjesht lënia “në qetësi” e pirtgut të kompostimit, deri në përfundimin e plotë të procesit, uljes së temperaturës në kosh dhe neutralizimit natyral të pH. Siç u tha edhe më sipër, për çdo rast, përpara përdorimit të produktit final, është e sugjerueshme analiza e një kampioni të produktit.

4. Kompostimi në Shkolla

Një program kompostimi i zbatuar në shkolla përbën një nga modelet më të përhapura të iniciativave në komunitet dhe institucionet arsimore. Pavaresisht se synon aplikimin praktik të skemave të kompostimit në komunitet, qëllimi kryesor është të ndërgjegjësohen dhe edukohen nxënësit dhe fëmijët rreth çështjeve të mbetjeve dhe të mbrojtjes së mjedisit. Programet e kompostimit nëpër shkolla mund të jenë një pikënisje të programeve të kompostimit në komunitet që mund të shtrihen në nivel lagjeje, fshati por edhe në nivel qyteti. Nxënësit dhe mësuesit mund të jenë bashkëpunëtorë shumë efektiv dhe cilësorë për të përçuar njohuritë dhe rregullat tek familjet e tyre dhe banorët e tjerë në një komunitet të caktuar. Një program kompostimi në shkolla mund të përfshijë një sërë hapash/ aktiviteteve si më poshtë:

4.1 Fillimi i procesit – koordinimi dhe miratimet me institucionet

Si çdo fillim procesi për herë të parë, edhe programet e kompostimit nëpër shkolla kanë nevojë për një proces informimi dhe komunikimi me institucionet përgjegjëse për administrimin e shkollave, përsa i përket programit arsimor dhe administrimit të shkollave, si psh. Drejtoria Arsimore, Bashkia/komuna, si dhe drejtuesit e shkollave. Qëllimi është të prezantohet programi,

objektivat, aktivitetet, burimet, kohëzgjatja, etj. Në fund të këtij procesi synohet të sigurohet mbështetja institucionale dhe administrative, ashtu dhe të përzgjidhen shkollat më të përshtatshme, si dhe të identifikohen çështjet, pengesat dhe të mendohen zgjidhje për adresimin e tyre. Për shkak të sfidave që mund të sjellë çdo proces i ri, rekomandohet që programi të përfshijë një numër të kufizuar shkollash në nivel pilot, dhe të kemi një zgjerim progresiv të programit vetëm nëse programi pilot njihet përmirësime.



Rekomandohet që çdo marrëveshje midis autoriteteve vendore dhe shkollave që shprehin interes të jenë pjesë e programit, të nënshkruhen marrëveshje mirëkuptimi apo bashkëpunimi, ku të përcaktojnë sa më qartë përgjegjësitë dhe mënyrën e bashkëpunimit midis tyre.

4.2 Ngritja e nje grupi pune dhe alokimi i përgjegjësi

Pavarësisht konsensusit dhe miratimit institucional, është e rëndësishme ngritja e një grupi pune brenda shkollave ku do të zbatohet projekti. Ky grup pune do të jetë përgjegjës për ngritjen dhe zbatimin e skemës së kompostimit, zbatimin e aktiviteteve të sensibilizimit, edukimit, monitorimin e progresit së procesit dhe marrjen e masave për përmirësimin e vazhdueshëm të tij. Grupi i punës në shkolla, mund të jetë i përbërë nga jo më shumë se 3-4 mësues dhe 10-12 nxënës, me detyra të përcaktuara qartë. Ky grup duhet të përfshijë mësuesit dhe nxënësit më të interesuar dhe të angazhuar për të kontribuar në vazhdimësi për programin. Angazhimi i mësuesve siguron më tej angazhimin dhe nxitjen e nxënësve në proces, garanton mbarëvajtjen e procesit dhe mundëson përmirësimin e kurrikulave mësimore dhe trajnimin e nxënësve. Përzgjedhja e nxënësve mund të jetë detyrë e mësuesve përgjegjës për programin e kompostimit, por njëkohësisht mund të përdoren pyetësorë të shkurtër për të përzgjedhur nxënësit më të interesuar.



Nga ana tjetër, nxënësit janë targeti grupi kryesor për programin e kompostimit. Të gjithë studentët në mënyrë direkte ose jo janë pjesë e procesit, pasi secilit prej tyre u duhet të ndajnë ushqimet, dhe mbetjet e tjera për ti bërë pjesë të përgatitjes së kompostit. Është e rëndësishme që studentët të prezantohen me projektin e kompostimit, në kohën e fillimit të shkollës, ose dhe më përpara, në mënyrë që procesi të fillojë në mënyrë të barabartë për të gjithë, me qëllim që angazhimi i nxënësve të rinj dhe zhvillimi i zakonit të kompostimit të nisë që herët. Disa nxënës mund të shfaqin interesin të jenë pjesë e grupit të punës brenda shkollës, përgjegjësia e së cilëve mund të jetë kontrolli paraprak i mbetjeve para se ato të përfundojnë në përgatitjen e kompostit, peshimin e materialve, matjen e temperaturës, kthimit të përgatitjes etj.

Autoritetet vendore duhet të krijojnë një grup koordinues dhe menaxhues të projektit, që drejtohet nga bashkia/komuna dhe mund të përfshijë përfaqësues të arsimit dhe shkollave.

4.3 Hartimi i një Plani Operacional

Grupi i punës i ngritur në çdo shkollë është përgjegjës për hartimin e një Plani të qartë Operacional ku përcaktohen aktivitetet, veprimet, rregullat dhe përgjegjësitë për secilën shkollë, në përputhje me planin e përgjithshëm të kompostimit i cili hartohet nga njësi vendore. Plani i operacional duhet të përmbajë edhe aspekte të komunikimit të brendshëm (midis grupit dhe brenda shkollës) dhe të jashtëm (me prindërit, me njësinë vendore, etj.); si dhe këshilla/mënyra/instrumenta për zgjidhjen e problemeve që mund të dalin gjatë zbatimit të programit. Në mënyrë masive dhe të organizuar, mund të organizohen java apo ditët e kompostimit, ku çdo klasë bëhet përgjegjëse për sjelljen e mbetjeve organike ashtu dhe kujdesin ndaj koshit të kompostimit (ajrosjen, monitorimin, etj.). një program sopecifik mund të përgatitet për këtë qëllim.

4.4 Hartimi i një programi sensibilizimi mbështetës

Fillimi i programit të kompostimit në shkollë, duhet sigurojë një nivel informimi dhe komunikimi me nxënësit, mësuesit dhe publikun e gjerë. Një program sensibilizimi mund të

hartohet dhe zbatohen në mbështetje të programit të kompostimit, që në këtë moment. Për të lançuar një program sensibilizimi mund të organizohen evente të hapura në ditë të rëndësishme mjedisore, festa lokale etj. Gjithashtu rekomandohet përdorimi i mjeteve të thjeshta të informimit si fletëpalosje, postera, etj. (për më shumë shih programin e sensibilizimit).

Kosh Falas: Bashkia Puke dhe Fushë Arrez mund të ofrojë kosh falas dhe asistencë për kryerjen e kompostit tuaj, nëse regjistrohesh në Programin e Kompostimit në Komunitet

I përshatshëm kudo: komposti mund të zhvillohet kudo në oborrin e banesës apo pallatit, pa shkakuar erëra të këqija

Plehu organik falas: për tokën/bahçen tuaj ose dhuroja lulishteve të qytetit; Plehu organik do të jetë gati brenda 3-6 muaj

10 minuta ne javë: Kërkon angazhimin tuaj për përzjerjen dhe mirëmbajtjen e koshit kompostimit

-30% 30% më pak mbetje: Redukton me 30-40% sasinë e mbetjeve urbane dhe tarifën e pastrimit

Për më shumë vizito :
<http://www.bashkiapuke.gov.al/>
<http://www.dldp.al/dldp/>
<http://www.co-plan.org/en/>
<http://www.universitetipolis.edu.al/>
<http://env-net.org/>

Regjistrohu në Programin Ndërkombëtar për Kompostimin në Komunitet
 1. Kontakto diekt në kontaktet e mëposhtme ose
 2. Dorëzo këte kupon pranë zyrave të bashkëe

Bashkia Pukë
 Tel: 0222 427
 Email: bashkiapukesh@ybh.co.com

Bashkia Fushë Arrez
 Tel: 0271 21111
 Email: bashkia_fusharrez@ybh.co.com

Në këtë ditë, përfaqësues nga grupi i punës së ngritur pranë NJQV-ve dhe ekspertë të fushës, do të mbajnë pranë studentëve prezantimin e metodologjisë për kryerjen e kompostimit në shkolla dhe avantazhet që vinë nga përqafimi i kësaj metode.

4.5 Rritja e njohurive teorike dhe praktike

Me qëllim, zhvillimin e një program të suksesshëm të kompostimit, nxënësit e shkollave si dhe stafi akademik, duhet të jenë pjesë e një programi për rritjen e njohurive mbi kompostimit dhe çështje të mbetjeve. Me zhvillimin e seksioneve të dedikuara, me pjesëmarrjen aktive të përfaqësuesve të njësisë vendore dhe ekspert të fushës, nxënës, mësues dhe prindër duhet të përftojnë njohuri mbi mjedisin, sjelljet mjedisore, llojet e mbetjeve dhe përbërjen e tyre, mënyrën e ndarjes së tyre etj.



Figura 1: Trajnimi i eksperteve locale për kompostimin ne komunitet në Pukë.

Njohuritë praktike të nxënësve rriten nëpërmjet organizimit të sesioneve/orëve të hapura të praktikës, pranë koshit të kompostimit. Çështje të tilla si përzierja apo ajrosja e kompostit, monitorimi i lagështirës dhe parametrave të tjerë, shoqëruar me njohuri dhe këshilla praktike duhet të bëhet pjesë e programit mësimor dhe programit të kompostimit në shkolla.

4.6 Përmirësimi dhe konsolidimi i programit të kompostimit

Programet e kompostimit mund të integrohen lehtë me kurikulat mësimore të edukimit 9-vjecar dhe të mesëm, duke u bërë pjesë e lëndëve të tilla si biologjia, edukimi mjedisor, sociologjia, puna me dru etj. Një pjesë e informacionit bazë duhet të sigurohet të përfshihet edhe në kurikulat mësimore, megjithatë hartimi i një plani të detajuar aktiviteteve për mbajtjen e forumeve të hapura informuese, është një detyrë e rëndësishme që duhet ndërmarrë nga stafi akademik dhe përfaqësues të njësisë vendore.

Një element i rëndësishëm për përmirësimin e programit të kompostimit është monitorimi i vazhdueshëm i skemës së kompostimit, që përfshin mbarëvajtjen e procesit në vetëvete, llojin e mbetjeve që dërgohen, monitorimi i temperaturës, lagështirës, dhe kompostit të prodhuar, etj.



4.7 Vazhdimi dhe mbështetja

Për të siguruar vazhdimësinë e programit të kompostimit në shkolla, është e rëndësishme që aktivitetet e kompostimit të mund lidhet me aktivitete të tjera sensibilizuese apo masa për shpëblimin e shkollave dhe pjesëmarrësve për punë të mirë apo për prodhimin e një materiali komposti të përshtatshëm, në cilësinë dhe sasinë e kërkuar.

Për shembull, materiali i prodhuar nga procesi i kompostimit mund të përdoret për një qëllim të caktuar, si psh. rritja e bimëve/ apo krijimi i mini-serave në mjediset e shkollës, apo përdorimi për lulishtet e qytetit dhe të gjetet një formë shpërblimi jo-financiar që të inkurajojë punën e mirë dhe aktivizimin.

5. Kompostimi në Komunitet”(Familje)

“Kompostimi në Komunitet” përfaqëson një metodë praktike jo vetëm për trajtimin e mbetjeve veçanërisht në nivel fshati dhe zonat ndër-urbane, por edhe si një mënyrë efektive për angazhimin dhe rritjen e njohurive të banorëve në zgjidhjen e problemit të mbetjeve urbane. Për më tepër mund të jetë si një nisje apo një process përgatitor për procese më të mëdha siç ndarja e mbetjeve në burim apo kompostimi i çentralizuar në nivel local.

Kjo metodë rezulton shumë më pak e kushtueshme dhe më efiksase sesa transferimi i mbetjeve organike në një landfill apo në pikat e depozitimit të mbetjeve. Nga pikëpamja mjedisore, kjo metodë mbetet e avantazhuar, mund të bëhet kudo dhe i jep mundësi familjeve që jo vetëm të reduktojnë në mënyrë të konsiderueshme mbetjet e tyre, por edhe të prodhojnë një produkt cilësor për përdorim familjar në kopshtet e tyre. Gjithësesi, aplikimi i kompostimit në komunitet duket më i përshtatshëm për shtëpitë me kopsht (shtëpi individuale) pasi kërkon një hapësirë të caktuar. Kjo metodë mund të jetë e përshtatshme për ndërtesat e përbashkëta (në oborrin e pallateve), kur ekziston një consensus për një aktivitete të tillë. Një program kompostimi në komunitet mund të përfshijë një sërë hapash/ aktiviteteve si më poshtë:

5.1 Ngritja e grupit të punës

Programi i kompostimit në komunitet vjen si një iniciativë e vetë NJQV-së, dhe departamenteve përkatëse. Për këtë arsye, ngritja një grupi punë të punës i cili do të përgatisë dhe do të ndjekë procesin duhet të nisë nga këto instanca vendore. Iniciativa për kryerjen e procesit të kompostimit duhet të jetë në përputhje të plotë me planet dhe objektivat strategjike të qytetit, për këtë arsye, aprovimi i Kryetarit të bashkisë/komunës, si dhe ndoshta informimi i Këshillit Bashkiak mund të jetë i nevojshëm përpara fillimit të procesit të kompostimit. Grupi i punës mund të përbëhet kryesisht nga përfaqësues të njërive vendore (drejtuar nga specialistët e fushës së mbetjeve/mjedisit), si dhe ndoshta përfaqësues të shkollave, shoqatave mjedisore, ekspertë të fushës ose jo që shfaqin interes dhe vullnet për të kontribuar në mënyrë direkte në procesin e riciklimit.

Grupi të punës, së ngritur për zbatimin dhe monitorimin e procesit të kompostimit në nivel komuniteti, i duhet të hartojë dhe të ndjekë një kalendar të qartë aktiviteteve për realizimin me sukses të procesit, sidomos në fazën përgatitore deri një nisjen e procesit të riciklimit. Një listë detyrash dhe përgjegjësish duhet të qartësohen midis grupit të punës, si psh. koordinatori apo drejtuesi i grupit, trajneri, monitoruesi, marrëdhënia me publikun dhe shoqatat mjedisore, etj., gjithësesi persona të veçantë mund të kryejnë disa nga pozicionet e mësipërme njëherësh.

Nevojitet që të zhvillohet një process trajnimi të anëtarëve të grupit të punës (ToT), sidomos anëtarëve që do të merren drejtpërdrejt me trajnimin e familjeve dhe shkollave pjesë e skemës së kompostimit. Grupi i punës do të jetë përgjegjës për përzgjedhjen e konsumatorëve dhe trajnimin e tyre, procesin e vendosjes/instalimit të koshave të kompostimit, monitorimin, garantimin e cilësisë, dhe dhënien e sygjërimeve, adresimi i problemeve dhe sigurimi i një tregu për kompostin e prodhuar.

5.2 Identifikimi i familjeve të cilat duan të jenë pjesë e programit të kompostimit – pyetësorët

Hapi i parë dhe më i rëndësishëm i fillimit të një procesi kompostimi në familje është identifikimi i familjeve të cilat duan të jenë pjesë e programit të kompostimit në komunitet.

Më poshtë janë disa nga mënyrat më të përshtatshme për të bërë të mundur këtë:

1. Identifikimi paraprak i familjeve të interesuara nga, nga inventarët e bashkisë, apo me ndihmën e kryetarëve të lagjeve të bashkisë/komunës. Në rastet kur kemi të bëjmë me njësi vendore relativisht të vogla, vetë njësi vendore mund të përgatisë një listë paraprake të familjeve potenciale që mund të përqafojnë programin dhe mund të shfaqin interes për

fillimin e kompostimit.. Gjithashtu, njësitë vendore mund të përcaktojnë lagjet apo banorët më aktivë, në iniciativa të ngjashme ndërgjegjësimiti, etj.

2. Anketimi: si proces që shërben jo vetëm për të komunikuar me familjet potenciale, por edhe për matur vullnetin/ gadishmërinë, por edhe për të ndarë me ta aspekte të tjera teknike të procesit mbi programin e kompostimit. Hartimi i pyetësorëve dhe zhvillimi i tyre, nuk shërben vetëm si një mjet identifikues i familjeve të cilat duan të jenë pjesë e procesit, por është hartuar në mënyrë të tillë që të mund të eksplorojë vullnetin dhe interesin e komunitetit për reduktimin e mbetjeve në burim, vullnetin për të qënë pjesë e trajnimeve për zgjerimin e njohurive, etj. Pyetësi duhet të përmbajë pyetje të thjeshta informuese, edhe mbi llojin e mbetjeve që gjenerojnë familjet, vullnetin që këto te fundit kanë për përfshirjen në proces, mundësitë infrastrukturore për ndërmarrjen e kësaj nisme si psh, a kanë hapësirë të mjaftueshme në oborret e shtëpive, kohë dhe interes direkt për kryerjen e procesit të kompostimit, etj. Një model pyetësori jepet si aneks i këtij udhëzuesi.
3. Programit/ aktiviteteve të njoftimit: Njësia vendore mund të bëjë njoftime në masë të familjeve dhe bizneseve nëpërmjet burimeve të ndryshme të informimit, në media, njoftimet në stendat bashkiake, lancimin e nismës në një aktivitet të hapur me nxënësit e shkollave në ditë mjedisore, etj. Përveç njoftimit paraprak, njësia vendore duhet të ngarkojë një zyrë/person përgjegjës dhe një numër telefoni/adresë emaili për të dhënë informacion specifik shtesë për programin dhe procesin e kompostimit.
Menjëherë pas identifikimit të familjeve të cilat duhet të jenë pjesë e skemës së kompostimit, njësia vendore mund të lidhë marrëveshje apo kontrata partneriteti për kryerjen e procesit të kompostimit si dhe për mirëmbajtjen e pajisjeve që do të vihen në dispozicion. Në vijim, grupi i punës i njësisë vendore, duhet të mundësojë rritjen e njohurive praktike, si fazë paraprake para fillimit të procesit.

5.3 Prezantimi paraprak

Nisma për nisjen e procesit të kompostimit, nis menjëherë pas identifikimit të familjeve të cilat duan të jenë pjesë e skemës. Në këtë kuadër, grupi i punës, duhet të ketë hartuar qartë një plan aktiviteteve për mbajtjen e një apo disa ëorkshopeve informuese mbi kryerjen e kompostit në familje.

Mënyra më e mirë e zhvillimit të prezantimeve, është bërja bashkë në një ditë të caktuar të të gjithë pjesëmarrësve dhe aktorëve në proces. Është e rëndësishme që, grupi i trajnuar i punës, të prezantojë hap pas hapi metodologjinë për kryerjen e kompostimit, duke i vënë theks të vecantë çështjeve të cilat duhen patur kujdes gjatë procesit.



Promovimi i kompostimit në komunitet në Prajonin e Pukës- përfshirja aktive e nxënësve (shkolla e mesme "Sabah Sinani") dhe studentëve

Eventi i hapur apo ëorkshopi mund të mbahet në një nga sallat e NJQV-së, e cila garanton hapësirën e mjaftueshme për të gjithë pjesëmarrësit ose një vend i hapur, psh., pranë një shkolle. Diskutimi cilësor dhe i përbashkët, garanton mbarëvajtjen e programit, dhe nxit bashkëpunimin ndër-familjar për kompostim.

5.4 Ndjekja dhe përmirësimi i procesit të kompostimit

Është detyrë dhe përgjegjësi e grupit të punës, që menjëherë pas lançimit të programit, të ndjekë në mënyrë të vazhdueshme procesin e kompostimit, duke siguruar, se të gjitha familjet pjesëmarrëse kryejnë siç duhet procesin dhe metodologjinë, zbatojnë rregullat, dhe prodhojnë kompostin në cilësinë dhe sasinë e duhur.

Duke qënë se procesi i kompostimit, ndikuar gjerësisht nga mënyra e kryerjes së tij, kërkon një kohë nga 2 deri 12 muaj, është e rëndësishme që grupi i punës të hartojë një kalendar për monitorimin e procesit i i cili mund të ndodhë 1 herë në 2 muaj.

Gjatë kohës që procesi i kompostimit është në vazhdim, është e këshillueshme të mbahen takime me palë të treta të interesuara, si përshembull, kompani të mëdha bujqësore të interesuara në blerjen e produkteve, përfaqësues të bizneseve lokale apo dhe blerës të mundshëm potencial rajonal, për të promovuar dhe mbështetur skemën e kompostimit.

Një numer kontakti i njësisë vendore do të sigurojë informim shtesë/ këshilla për konsumatorët eksistues dhe konsumatorët e rinj,apo për të adresuar probleme të ndryshme me procesin apo me marrjen e kompostit të prodhuar, etj.

5.5 Subvencionimi i skemës së kompostimit

Për të nxitur familjet ti bëhen pjesë e skemës, sygjerohet që të aplikohet një një subvencionim i investimeve fillestare si blerja ose sigurimi I materialeve për koshin e kompostimit. Kosto e

përafërt për ndërtimin e një set –koshi (dy kosha) kushton rreth 10'000-20'000 lekë. Në një moment të dytë kur skema është konsoliduar mund të skema e subvencionimit mund të transformohet në një skemë bashkëfinancimi.

6. Programi i Vlerësimit dhe Monitorimit

“Nëse nuk matni rezultatet, nuk mund të dalloni suksesin nga dështimi. Nëse nuk mund të dalloni suksesin, nuk mund të vlerësoni dot rezultatet. Nëse nuk shihni suksesin, nuk mund të mësoni dot prej tij. Nëse nuk dalloni dot dështimin, nuk mund ta korrigjoni dot atë. Nëse mund t'i tregoni rezultatet, mund të fitoni mbështetjen e publikut; çdo gjë që matet mund të realizohet.”

Monitorimi dhe dokumentimi janë instrumente shumë të rëndësishme për të përmirësuar sistemin apo për ta adoptuar atë. Pa mbledhjen e vazhdueshme të të dhënave gjatë procesit të kompostimit nuk do të mund të përcaktohen dhe analizohen kriteret e performancës për programin e kompostimit të mbetjeve në komunitet. Grupi i punës, i ngritur pranë njësite vendore duhet të mbajë në mënyrë periodike dhe të përditësuar një regjistër të saktë të dhënash.

Mbledhja e këtyre të dhënave nuk mund të kryhet pa angazhimin dhe përpjekjen e përbashkët të të gjithë aktorëve të përfshirë në proces. Në këtë kuadër do të kërkohej angazhimi i aktorëve si : kryefamiljarët e familjeve , pjesë të skemës së kompostimit, krerët e lagjeve, inspektorë të fushës dhe stafi bashkiak etj.

Grupi i punës duhet të zhvillojë një paketë të plotë indikatorësh monitorimi, në mënyrë që të masë dhe vlerësojë performancën e procesit të kompostimit. Më poshtë rekomandohen disa nga indikatorët për monitorimin e performancës:

- Numri i saktë i familjeve të cilat janë angazhuar në skemën e kompostimit, duke I klasifikuar ato në dy grupe kryesore në bazë të mënyrës (active ose passive) të kryerjes së kompostimit. Ky informacion duhet të jetë i plotë që me fillimin e procesit të kompostimit, në mënyrë të tillë që të mund të kalkulohej më me lehtësi kostot që do të nevojiten për blerjen apo ndërtimin e koshave.
- Numri I pjesëmarrësve aktiv në aktivitetet e organizuara në kuadër të programit të kompostimit, për të kuptuar nëse programi I kompostimit shfaq inters dhe është kuptuar nga të gjithë
- Sasia e mbetjeve organike të gjeneruara cdo ditë nga familjet/shkolla. Vlefshmëria e këtij informacioni kërkon angazhim të gjerë dhe të përgjegjshëm të të gjithë aktorëve të cilët kryejnë procesin e kompostimit, matja e mbeturinave të gjeneruara të së cilëve duhet të

kryhet në mënyrë të saktë dhe të vazhdueshme. Nga ana tjetër matja e këtij indikatori, ndihmon në përcaktimin e përafërt të produktit final që do të vijë si pasojë e kompostimit

- Në mënyrë periodike, 1 herë në 2 muaj, apo 1 herë në 2 javë inspektorët e kompostimit, duhet të ndjekin dhe analizojnë nga afër procesin e kompostimit në secilën familje me qëllim, garantimin e mbarëvajtjes dhe procesit, si dhe monitorimin në kohë deri në përfundimin e produktit final
- Sasia e gjeneruar e kompostit dhe kohëzgjatja e procesit.
- Kontrolli I kënaqësisë qytetare mund të kryhet nëpërmjet anketave në ditë të vecanta, sipas kalendarit të programuar nga grupi I punës.

7. Aneksi 1: PYETËSOR PËR KOMPOSTIMIN NE KOMUNITET TE MBETJEVE

Nr. _____

Anketuar nga: _____ Bashkia/ komuna _____

1. Informacion mbi te anketuarin:

I anketuari _____ (emer/mbiemer)

Adresa e plote: _____

Numri gjithsej i familjareve _____; Nr. i femijeve _____ (ne moshen shkollore)

Kontaktet:

Telefon: _____ / email: _____;

2. Cfarë bëni me mbetjet e gjeneruara në shtëpinë tuaj?
- a. Depozitojmë në kazanë b. I djegim c. ushqim për kafshet
- d. I hedhim ku të mundemi e. I groposim. f. për pleh

2.1 po me mbetjet organike:

Zgjidh njërën nga alternativat e mësipërme: _____

3. A e paguani tarifën e grumbullimit të mbetjeve?
- a. Po b. Jo
4. A jeni në dijeni të metodës së kompostimit? Nëse po cfarë dini për të?
- a. Po b. Jo
-
5. A do të ishit të interesuar të bëheshit pjesë e një iniciative lokale kompostimi në komunitet, të bëni kompostim brenda oborrit?
- a. Po b. Jo c.) se di
6. Nëse po (5/a), për çfarë do të përdornit plehun organik?
- a. Për bahçen/token b. për seren c. për kopshtin
- d. do ja dhuroja bashkë e. do e shisja f. se di
7. Nëse po (5/a), a do të preferonit një proces kompostimi:
- a. Aktiv (duke e përzier në mënyrë frekvente plehun, plehu është gati për 3-4 muaj)
- b. Pasiv (pa e përzier, plehu do të jetë gati pas 9-12 muaj)
8. Nëse alternative 5/b ose 5/c, a do të ishit i interesuar të kompostonit mbetjet për një tarifë me të ulët?
- a. Po b. Jo
9. Nëse po (alternative 5/a), a do të ishit të interesuar të marrnit pjesë në një seancë trajnimi për kompostimin?
- a. Po b. Jo